



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

FTESË

Bashkëbisedim për Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut,

Data: 10 dhjetor 2024

Vendi: Amfiteatri i vogël i Fakultetit Juridik, Universiteti i Prishtinës

Koha: 11:00 deri 12:30

I nderuari z. Hajrullahu,

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, më 10 dhjetor 2024, Avokati i Popullit në bashkëpunim me Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” organizojnë një bashkëbisedim me studentët, shoqërinë civile, përfaqësuesit e institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare dhe përfaqësuesit e mediave, përkitazi me vlerat dhe parimet e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut që mbrojnë dinjitetin, lirinë, barazinë, mirëqenien e individëve si dhe edukimin për të drejtat e njeriut. Edukimi për të drejtat e njeriut synon rritjen e ndërgjegjësimit dhe fuqizimin e individëve për të mbrojtur dhe kërkuar respektimin e të drejtave të tyre dhe të të tjerëve.

Kjo datë e rëndësishme për të drejtat e njeriut, në këtë vit shënon përvjetorin e 76-të të miratimit të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10 dhjetor 1948. Nën slloganin *"Të Drejtat tona, e Ardhmja Jonë, që Tani"* (*"Our Rights, Our Future, Right Now"*) OKB-ja këtë vit rikujton rëndësinë e të drejtave të njeriut për t'i fuqizuar individët dhe komunitetet për të ndërtuar një të nesërme më të mirë.

Andaj, për ta shënuar **Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut**, ju ftojmë të merrni pjesë në panelin e ngjarjes, e cila do të mbahet më **10 dhjetor 2024**, në **Amfiteatrin e vogël të Fakultetit Juridik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”**, prej orës **11:00 deri 12:30**.

Ju mirëpresim!

Me nderime,
Naim Qelaj
Avokat i Popullit

Bashkëngjitur: Agjenda



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

AGJENDA

Bashkëbisedim për Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut

Data: 10 dhjetor 2024

Vendi: Amfiteatri i vogël i Fakultetit Juridik, Universiteti i Prishtinës

Koha: 11:00 deri 12:30

11:00 – 11:05	Hapja dhe moderimi i takimit: Z. Florent Muçaj, Prodekan për çështje mësimore dhe të cilësisë i Fakultetit Juridik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
11:05 – 11:15	Z. Naim Qelaj, Avokat i Popullit <i>“Avokati i Popullit, si mekanizëm për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, gjendja e të drejtave të njeriut-gjetjet e Avokatit të Popullit”</i>
11:15 – 11:25	Znj. Gresa Caka-Nimani, Kryetare e Gjykatës Kushtetuese (TBC) <i>Roli i Gjykatës Kushtetuese në mbrojtjen e të drejtave të njeriut</i>
11:25 – 11:35	Z. Arben Hajrullahu, Rektor i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” <i>Roli i Universitetit në avancimin e edukimit për të drejtat e njeriut</i>
11:35 – 11:45	Znj. Igballe Rogova, Aktiviste e të drejtave të njeriut dhe përfaqësuese e shoqërisë civile <i>Roli i Shoqërisë Civile dhe avokimi për respektimin e të drejtave të njeriut</i>
11:45 – 11:55	Z. Naim Qelaj, Avokat i Popullit <i>Leximi i Deklaratës së Avokatit të Popullit me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut</i>
11:55 – 12:30	Diskutim i hapur